



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Inspektionit
Periudha Raportuese	Prill
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Zana Gojani

1. PËRMBLEDHJE

Gjatë muajit prill mbarëvajtja e punëve ishte në nivelin e duhur, me përjashtime të emergjencave eventuale të paparashikuara.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Aktivitetet e planifikuara ishin:

- Parandalimi i uzurpimeve të hapësirave publike dhe komunale;
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Parandalimi i ndotjes së ambientit;
- Mbikëqyrja e transportit publik;
- Vendosja e ligjshmërisë për shitësit ambulante dhe parkingjet ilegale;
- Vendosja e ligjshmërisë në fushën e lojërave të fatit;
- Parandalimi i keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të ujit të pijshëm;
- Mbikëqyrja e punës së subjekteve juridike dhe afariste, me qëllim të përmbushjes së ligjshmërisë;

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërhyrja më procesverbale dhe gjoba mandatore;
- Ndërprerja e punës së aktiviteteve pa leje;
- Rrënimi i objekteve pa leje etj.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Aktivitetet i implementuar gjatë periudhës raportuese:

- Largimi i shitësve ambulantë - 148
- Largimi i reklamave nga shtyllat - 42
- Konfiskimi i automjeteve - 39
- Lëndë te iniciuara për Gjykatë për Kundërvajtje - 43
- Parandalimi i uzurpimeve të hapësirave publike dhe komunale;
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Mbikëqyrja e transportit publik;
- Vendosja e ligjshmërisë për shitësit ambulantë dhe parkingjet ilegale;
- Vendosja e ligjshmërisë në fushën e lojërave të fatit;
- Parandalimi i keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të ujit të pijshëm;
- Mbikëqyrja e punës së subjekteve juridike dhe afariste, me qëllim përmbushjen e ligjshmërisë;
- Ndërhyrja më procesverbale dhe gjoba mandatore;
- Ndërprerja e punës së aktiviteteve pa leje;
- Rrënimi i objekteve pa leje etj.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Aktivitetet në zbatim:

- Ristrukturimi;
- Digjitalizimi;
- Identifikimi i trajnimeve të nevojshme;
- Identifikimi i rregulloreve të nevojshme;
- Bartja e Sektorit të pylltarisë nga Drejtoria e Zhvillimit në Drejtorinë e Inspektionit etj.

5. STATISTIKAT

5.1.1. Takimet me palë:

- Drejtori – 10 palë;
- Sektori i ndërtimit – 70 palë;
- Sektori komunal – 65 palë;
- Sektori i komunikacionit – 30 palë;
- Sektori sanitar – 30 palë.

5.1.2. Takimet me institucione të tjera:

- DUNMM;
- NPB;
- Policia e Kosovës;
- Drejtorja e Shërbimeve Publike;
- Drejtorja e Infrastrukturës Lokale etj.

5.1.3. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Sektori komunal – 82 lëndë;
- Sektori i Ndërtimit – 80 lëndë
- Sektori i Komunikacionit - 87 lëndë;
- Sektori Sanitar 31 lëndë.

6. SFIDAT

- Mungesa e kompanisë rrënuese;
- Numri i vogël i punëtorëve;
- Mungesa e deponisë;
- Mungesa e thertoreve;
- Mungesa e tregut të druve /thëngjillit;
- Mungesa e rregullores për ndotje akustike;
- Mungesa e rregullores për vendpunishte;
- Mungesa e udhëzuesit për tarraca;
- Mungesa e shërbimit “Merimangë”, veçmas për Drejtorinë;
- Mungesa e rregullores për parkingje private;
- Mungesa e Ligjit për Prishtinën etj.

7. REKOMANDIME

- Angazhimi i kompanisë rrënuese;
- Shtimi i numrit të punëtorëve;
- Caktimi i lokacionit dhe krijimi i kushteve për një deponi legale;
- Krijimi i një thertoreje;
- Caktimi i lokacionit për tregun e druve dhe thëngjillit;
- Takimi me Ministrinë e Ambientit për sqarimin rreth inspektimit të ndotjes akustike;
- Caktimi i grupit punues për rregulloren dhe doracakun për vendpunishte;
- Caktimi i grupit punues për doracakun për shfrytëzimin e tarracave;
- Shtimi i bashkëpunimit mes Drejtorisë së Inspektionit dhe Shërbimit “Merimangë”;
- Caktimi i grupit punues për mbikëqyrjen e parkingjeve private;
- Ligji për Prishtinën.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Përpilimi dhe fuqizimi i rregulloreve të nevojshme, në bashkëpunim me drejtoritë tjera komunale;
- Ristrukturimi;
- Transferimi i Sektorit të mbrojtjes së pyjeve dhe bujqësisë në Drejtorinë e Inspektionit;
- Vizita në terren në baza ditore, me qëllim të:
 - o parandalimi të uzurpimeve të hapësirave publike dhe komunale,
 - o parandalimit të ndërtimeve pa leje,
 - o parandalimit të ndotjes së ambientit,
 - o mbikëqyrjes së transportit publik,
 - o vendosjes së ligjshmërisë për shitësit ambulantë dhe parkingjet ilegale;
 - o vendosja e ligjshmërisë në fushën e lojërave të fatit;
 - o parandalimi i keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të ujit të pijshëm;
 - o mbikëqyrja e punës së subjekteve juridike dhe afariste, me qëllim përmbushjen e ligjshmërisë.